



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1043/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit The Procter & Gamble Company, me seli ne Cincinnati, Ohio, te Shteteve te Bashkuara te Amerikës, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naser Peci, avokat ne Prishtine, kundër te paditurës "ABI", SH.P.K., me NUI: 81057558, me seli ne rrugën "Komuna e Parisit", ne Prizren, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Murati avokat nga Prishtina, për shkak te shkeljes se markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkalles se parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.2547/22 e datës 25.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e te paditurit "ABI", shpk., me NUI: 81057558, me seli ne Prizren dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti Ekonomik KE.nr.2547/22 e datës 25.01.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti Ekonomik, me aktgjykimin ankimor KE.nr.2547/22 e datës 25.01.2024, ka vendosur më sa vijon:

I. APROVOHET ne tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit The Procter & Gamble Company dhe VERTETOHET se i padituri "ABI", SH.P.K., me datën 12.09.2022, përmes importimit te 896 thasëve detergjent ne paketim prej 7 kilogram, ne sasinë e përgjithshme prej 6272 kilogram, ka shkelur markat tregtare te regjistruara te paditësit "P&G", "Ariel Professional" dhe "Ariel Color Activ".

II. URDHEROHET shkatërrimi i produkteve te cekura si ne piken I te këtij dispozitivi, me shpenzimet e te paditurit, ne afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

III. OBLIGOHET i padituri qe me shpenzime te tij ta publikoj këtë aktgjykim ne dy medime te Republikës se Kosovës, ne afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET i padituri qe paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumën e përgjithshme prej 425.40 € (katërqind e njëzet e pese euro e katër dhjetë cent), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala paditur, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si

e bazuar dhe të prishet aktgjykimi ashtu që të aprovohet kërkesëpadia ose lëndën ta prish dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Pala paditëse ka dhënë përgjigje në ankesë, me pretendimin që ankesa të refuzohet në tërësi si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Komerciale e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi The Procter & Gamble Company, me seli në Cincinnati, Ohio, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naser Peci, avokat në Prishtinë, ka ushtruar padi me datë 11.10.2022, pranë Gjykatës Komerciale, ndaj të paditurit "ABI", SH.P.K., me NUI: 81057558, me seli në rrugën "Komuna e Parisit", në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Murati avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljes së markës tregtare.

Pala paditëse si gjatë shqyrtimit gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtar ka deklaruar se me datën 13.09.2022 është njoftuar nga Dogana e Kosovës, se është pezulluar lirimi i mallrave të të paditurit për shkak të dyshimit se të njëjtat shkelin markën tregtare të paditësit, duke shtuar se malli i importuar nga ana e të paditurit e që është pezulluar nga ana e doganës, përbehej në sasi prej 896 thasëve të detergjentit, në paketim prej 7 kilogramëve, gjithsej në sasinë prej 6727 kilogram. Ka shtuar që paketimi me fjalën "Ariel", ishte i ngjashëm me paketimin e paditësit, ndërsa importimi nuk kishte qenë i autorizuar nga ana e paditësit si dhe produkti nuk kishte prejardhje nga ndonjë prej distributoreve të autorizuar të paditësit. Në rastin konkret i padituri, këto produkte i kishte importuar nga kompania Lensis Cosmetics, ndërsa nga konfirmimi i aktit të paditësit të datës 21.09.2022 është konstatuar se produktet e lartcekura nuk janë prodhuar nga ana e paditësit apo njësite e saj dhe se këto produkte janë të falsifikuara, ngase përmbajnë shenja dalluese nga produktet origjinale, duke shtuar se i padituri me importimin e këtyre produkteve ka shkelur markat tregtare të paditësit. Ndërsa sa i përket pretendimeve të paditurit se produkti është blerë nga distributori i autorizuar i paditësit, ka theksuar se një pretendim i tillë nuk qëndron meqenëse nuk ka prova mbështetëse për një pretendim të tillë, po ashtu pala paditëse ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar fakti se i padituri me importin e datës 13.09.2022 ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit dhe për më tepër nga konfirmimi mbi origjinalitetin e mallit të ndaluar, lëshuar nga paditësi me datën 21.09.2022 pasqyrohen dallueshmëri përmbajtësorë në mes të produktit origjinal dhe atij të ndaluar, nga e cila vërtetohet se produkti i ndaluar nuk është prodhuar nga ndonjë njësi e paditësit apo është distribuuar nga ndonjë i autorizuar i paditësit, si dhe duke marrë për bazë edhe faktin që paditësi nuk prodhon fare detergjent me paketim 7 kg.

E paditura në kundërshtimet e saj të prezantuara në formë të shkruar dhe verbalisht në seanca ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse duke theksuar se produktet kontestuese janë produkte origjinale dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me importimin paralel të tyre, gjë e cila është e lejuar me nenin 14 të LMT-se, pasi që në rastin konkret importimi i produkteve në fjalë është bërë nga shteti i Turqisë, me të cilën Republika e Kosovës ka marrëveshje të tregtisë së lire dhe nga provat të cilat janë bashkëngjitur me përgjigjen në padi prodhuesi ka konfirmuar se produktet që janë importuar prej kompanisë Lensis Cosmetics janë origjinale gjë e cila vërtetohet edhe nga raporti i testimit nga testues të specializuar, duke shtuar se barra e provës në këtë rast i takon

paditësit që të dëshmojë nëse produktit i është ndryshuar përmbajtja edhe pse nga provat e dorëzuara nga ana e të paditurit vërtetohet origjinaliteti i produktit. Në fund i padituri ka theksuar se nga provat e administruara vërtetohet se produktet kontestuese dhe janë importuar nga paditësi janë produktet origjinale dhe autentike të prodhuara nga vetë paditësi e të cilat paditësi paraprakisht i kishte vënë në tregun e Turqisë, nga ku edhe është furnizuar i padituri dhe se në rastin konkret nuk ka shkelje të markës tregtare pasi që ligji në fuqi ka lejuar importin paralel. I ka propozuar gjykatës që kërkesë-padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e Komerciale e Kosovës, si gjykatë e shkallës së parë, pas administrimit të provave si:

Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr.2727, nr. aplikimi KS/R/2008/633, i datës 15.05.2008; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 7197, nr. aplikimi KS/ R/2008/693, i datës 27.05.2008; Ekstrakti i lëshuar nga API për markën tregtare KS/R/2008/000488, nr. i regjistrimit 000123, i datës 29.01.2010; Liste distribuimi - njoftim nga Dogana e Kosovës - rasti 364 Ariel i datës 13.09.2022; Foto dokumentacioni në përbërje prej pesë fotografive; Deklarata - betim me shkrim lëshuar nga paditësi i datës 21.09.2022 mbi konfirmimin e origjinalitetit të produktit; komunikimi me email i lëshuar nga Yakup Bag - menaxher eksporti i kompanisë Lensis Cosmetics; Formulari i të dhënave të sigurisë P&G, i datës 03.09.2020, në përbërje prej 13 faqeve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke; Komunikimi me email i lëshuar nga Yakup Bag - menaxher eksporti i kompanisë Lensis Cosmetics, i datës 29.09.2022 i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i dorëzuar në gjuhën angleze; Raporti i auditimit Destek i datës 20.06.2022 - rendi YMM - 1274 - 2022/061 me temën Sigurim i informacionit; Raport testimi i datës 01.11.2022 - nr. Raporti TR220929-RV1 dhe ekstrakti i nxjerrë nga ueb faqja google e paditësit për selinë dhe njësitë e saja në Turqi të datës 23.01.2024. Me aktgjykimin e ankimuar ka vendosur duke e aprovuar si të bazuar kërkesë-padinë e paditëses, me arsyetimin se nga provat e administruara, gjykata vërtetoi se paditësi me të paditurin në mes vetë nuk kanë pasur raport kontraktuar dhe se mallrat e ndaluara nga Dogana e Kosovës nuk janë mallra të prodhuara nga ana e paditësit edhe pse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk kanë asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijojë bindjen se behet fjale për produktet e paditësit. Gjykata vlerësoi formularin e të dhënave të sigurisë P&G, të datës 03.09.2020, raportin e auditimit Destek të datës 20.06.2022 - rendi YMM - 1274 - 2022/061 me temën Sigurim i informacionit, si dhe raportin e testimit të datës 01.11.2022 - nr. Raporti TR220929-RV1, të dorëzuara nga i padituri dhe gjeti se nga këto dokumente nuk vërtetohet se mallrat kontestuese, që janë importuar nga ana e kompanisë Lensis Cosmetics janë origjinale dhe kjo për faktin se nga të dhënat e sigurisë P&G, të datës 03.09.2020, rezulton vetëm se është bërë identifikimi i substancave/përzierjes së produktit me emrin Ariel Aqua Pudra Dag Esintisi, sipas identitetit të produktit 91365209_RET_CLP. SA, mirëpo nga e njëjta nuk mund të vërtetohet ndonjë lidhshmëri me produktin i cili është ndaluar nga Dogana e Kosovës nën dyshimin për shkeljen e markave tregtare të paditësit.

Me tej ka theksuar se nga provat në shkresë të lëndës si fotot e prezantuara shihet qartë se produkti i paditësit dhe i të paditurës kanë ngjashmëri që mund të shkaktojë konfuzion të konsumatori, pasi ngjyrat, nuancat, dizajni, pjesëmarrja dhe kombinimi i këtyre ngjyrave në produkte nuk dallojnë dukshëm. Andaj gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në nenin 8 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare (tutje referuar si "LMT"), dhe citoj: "1. Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij: 1.1. çdo shenje, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare; 1.2. çdo shenje që shtet identike ose e

ngjashme me markën apo qe, per shkak të njëlojshmërisë apo ngjashmërisë se mallrave ose shërbimeve, per te cilat perdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, ge mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e asociimit se shenjës me markën tregtare; 1.3. çdo shenje, qe është identike apo e ngjashme me markën tregtare për produktet dhe shërbime te ndryshme nga ato për te cilat është regjistruar marka tregtare, kur kjo e fundit ka reputacion ne Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak te arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejte ose dëmtohet natyra dalluese apo emri te njohur te markës", dhe gjithashtu duke cituar par. 3: "Te drejtat qe rrjedhin nga regjistrimi i markës kanë efekt mbi palët e treta qe nga data e publikimit te regjistrimit te markës tregtare. Mund te kërkohet kompensim per shkeljen e markës ge ndodhin pas datës se publikimit te aplikimit të markës tregtare, shkeljet te cilat pas publikimit te regjistrimit të markës tregtare duhet të ndalohen.

Më tutje, Gjykatë e shkalles se pare, ka konstatuar se te drejtat nga markat tregtare konsiderohen te drejta pronësore për gjatë kohës se vlefshmërisë se markës tregtare dhe brenda territorit brenda te cilit është regjistruar, dhe rrjedhimisht përbejnë te drejta absolute dhe kjo nënkupton se titullari i markës tregtare mund t'i ndaloje palët e treta qe pa pëlqimin e tij te përdorin shenjen identike ose te ngjashme per mallrat apo shërbimet e llojit te njëjtë ose te ngjashëm dhe pasi qe kemi te bëjmë me një marke tregtare te regjistruar, e cila ia nje ia nje pronarit ekskluzivitetin e përdorimit,

Gjykata ka vërtetuar se janë te bazuara pretendimet e palës paditëse për mundësinë e shkaktimit te konfuzionit, per arsye se shkelje e markës tregtare konsiderohet edhe imitimi i saj, transkriptimi, transliterimi si dhe kur shenjës i shtohen fjale, shkronja dhe te ngjashme. Lidhur me shpenzimet e te paditurit per shkaterrimin, magazinimin e produkteve si dhe shpenzimet për publikimin e ketij aktgjykimi, gjykata e vendosi konform dispozitave te nenit 28 dhe 99 te Ligjit Nr. 05/L-026 si dhe Ndryshimin dhe Plotesimin e Ligjit 05/L-040 për Marka Tregtare. Kurse vendimin për caktimin e shpenzimeve procedurale, gjykata e ka vendosur konform nenit 452 par. 1 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, ndërkaq lartësinë e kërkesës e caktoi sipas tarifës se Odes se Avokateve te Kosovës, për këto shpenzime: ne vlere prej 425.40

Gjykata e shkalles se dyte, ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë faktike drejt është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të dallueshmërisë respektivisht ngjashmërisë së produktit të mbrojtur të paditësit me markë tregtare dhe produktit të së paditurës, ka marrë për bazë kriteret të qëndrueshme.

Gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve, gjykata duhet ta ketë parasysh: natyrën e mallrave dhe të shërbimeve, perceptimin e konsumatorit mesatar dhe faktin nëse këto dy ndërmarrje janë në konkurrencë me njëra tjetrën, por për vlerësimin e shkallës së ngjashmërisë në mes të markave duhet merren parasysh: shkalla e ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkalla e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), si dhe shkalla e ngjashmërisë konceptuale.

Ne rastin konkret markat tregtare e regjistruar nga paditësi përben marke tregtare sugjestive e cila gëzon mbrojtje te forte juridike. Sipas Nenit 8 te Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), të drejtat nga markat tregtare konsiderohen te drejta pronësore dhe te njëjtat përbejnë te drejta absolute. Kjo nënkupton se te gjitha palët e treta obligohen qe të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare te regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndaloje palët e treta qe pa pëlqimin e tij te përdorin shenjen identike ose te ngjashme për mallrat apo shërbimet te llojit te njëjtë ose te

ngjashme. Me regjistrimin e një marke te caktuar, bartësi i markës tregtare fiton te drejtën ekskluzive mbi markën tregtare. Thelbi qëndron ne funksionin themelor te markës - identifikimit te origjinës se produktit apo shërbimit.

Bartësi i markës se regjistruar tregtare gëzon një numër te drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës se regjistruar tregtare ka drejta te: ndaloje përdorimit e paautorizuar te markës tregtare te tij përmes mjeteve juridike ne dispozicion (Nenet 8 - 13 i LMT); te përdorë markën e regjistruar ne tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe te disponoje me markën tregtare te tij (Nenet 15 - 22 i LMT). Mbajtësi i një marke tregtare sipas Nenet 8 te LMT-se, ka te drejte te ndaloj: vendosjen e markës se mbrojtur, na mallra, ne paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij ne treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare te tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare; përdorimit e markës se mbrojtur ne dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit te saj sipas Nenet 8 te LMT-se, përben shkelje te markës tregtare. Shkelja mund te behet me çdo veprim te ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me te cilin atakohet te paktin njëren prej te drejtave te pronarit te markës tregtare. Kjo shkelje mund te behet gjate kohës se vlefshmërisë se markës tregtare, brenda territorit për te cilën ajo është e autorizuar.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1043/2024 me datën 09.07.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami